a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Nr.	Pershkrimi	Sasia	Njesia	Cmimi	Vlera Totale
1	Analiza dhe Projektimi i i Kërkesave	1	Set		
2	Zhvillimi i Softuerit / Modulet (Ndryshime dhe përmirësime në ndërfaqet web)	1	Set		
3	Integrimi me Sistemet Ekzistuese	1	Set		
4	Upgrade i server të aplikacionit, server te databazes ne versionet me te fundit;	1	Set		
5	Upgrade i sistemit të operimit për server të aplikacionit dhe server te databases;	1	Set		
6	Optimizimi i proceseve të punës të sinkronizimit me skemën ndërmjetëse;	1	Set		
7	Testim dhe Sigurim Cilësie (QA) (Teste funksionale, UAT, pen-test, testim i performances)	1	Set		
8	Trajnim te perdoresueve (End User) Si dhe trajnim teknike te stafit te IT	1	Set		
9	Raportimi, dorezimet e procedurave Teknike si dhe manualat e perdorimit	1	Set		

	Çmimi total	
Çmimi Neto pa TVSH		
TVSH (%)		
Çmimi total me TVSH:		
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit		
Nënshkrimi		
Vula		
Datë _____		

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik]

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi. like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Sipas termave të references

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Permbajtja

1. HYRJE	30
1.1. Qëllimi	31
1.2. Objektivat.....	31
2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I SISTEMIT	33
2.1 Përshkrimi i përgjithshëm i sistemit	33
2.2 Analiza e situatës ekzistuese	34
2.3 Projektimi teknik dhe përzgjedhja e teknologjisë.....	34
2.4 Implementimi i infrastrukturës dhe aplikacioneve	34
2.5 Testimi funksional dhe teknik.....	34
2.6 Trajnimi dhe dorëzimi	35
2.7 Mbështetja pas implementimit.....	35
3. REZULTATET QË DUHET TË ARRIHEN	35

3.1. Infrastrukturë moderne dhe funksionale

3.2 Sisteme CRM dhe Billing të përditësuara.....	35
3.3. Integritime funksionale me sisteme të tjera	35
3.4. Dokumentacion teknik dhe përdorues	35
3.5. Raporte të testimeve dhe verifikimeve	36
3.6. Trajnime dhe transferim njohurish	36
3.7. Raport përfundimtar i projektit.....	36
4. SUPOZIMET DHE RISQET	36
5. DETYRAT SPECIFIKE	36
5.1 Fazat e Implementimit të Projektit.....	36
5.2 Dorëzimet.....	38
5.3 Mbikëqyrja dhe Raportimi.....	39
5.4 Mbledhja, specifikimi dhe dokumentimi i analizës së kërkesave.....	40
6. KËRKESAT FUNKSIONALE	41
6.1 Upgrade i Platformes Billing/CRM	41
6.2 Ndryshime dhe përmirësime në platformen Billing/CRM	41
6.2.1 Moduli Customer Support.....	42
6.2.2 Moduli Billing (Faturim)	55
6.2.3 Moduli Payment.....	59
6.2.4 Moduli Metering	63
Tarifa e Energjisë Reaktive – Billing x Metering.....	75
6.2.5 Moduli Service Connections.....	75
6.2.6 Moduli Disconnection & Dismantlement	81
6.2.7 Moduli Energy Balancing System	82
7. LOGJISTIKA DHE KOHA	86
7.1 Vendndodhja.....	86
7.2 Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave	86

1. RAPORTIMI	86
Kërkesat per Raportimin	86
2. SIGURIA E SISTEMIT	87
2.1 Përditesimet e komponenteve	87
9.1 Implementim i sigurt	87
9.2 Testimi i sigurisë	87
9.3 Sesionet active	87
9.4 Administratorët	87
9.5 Disponueshmëria e sistemit	88
9.6 Kufizimet e mundshme ndaj disponueshmërisë së shërbimit	88
9.8 Përgjigja dhe shkallëzimi I shërbimit.	90
10. GRAFIKU I LEVRIMIT	92
11. TRAJNIMI	93
12. TE DREJTAT E KODIT	94
13. KËRKESAT TEKNIKE	94

1. HYRJE

Sistemi Informatik Billing & CRM aktualisht shërben si platforma qendrore për menaxhimin e marrëdhënieve me klientët dhe proceset e faturimit në katër kompanitë që përbëjnë OSHEE Group sh.a. Ky sistem mbështet një gamë të gjerë funksionalitetesh që lidhen me:

- Regjistrimin dhe menaxhimin e klientëve
- Lidhjen dhe ndërprerjen e kontratave të energjisë
- Përllogaritjen dhe gjenerimin e faturave
- Menaxhimin e pagesave dhe detyrimeve
- Trajtimin e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve
- Raportimin teknik dhe financiar

Pas shumë viteve në operim aktiv, infrastruktura teknologjike (hardware dhe software) që mbështet sistemin është bërë pjesërisht e vjetruar dhe ka nevojë për modernizim. Po ashtu, disa prej moduleve dhe funksionaliteteve duhet te pershtaten në mënyre optimale me kërkesat në rritje të kompanive dhe të tregut të energjisë.

Në këtë kontekst, do të ndërmerret një proces gjithëpërfshirës për përmirësimin e teknologjisë ekzistuese, që përfshin:

- Upgrade të infrastrukturës hardware dhe software
- Përditësim të funksionaliteteve ekzistuese të sistemit CRM dhe Billing
- Zgjerim të mundësive për integritet të reja me sisteme të tjera, si ERP, WFM, portalet digjitale, platformat analitike, dhe aplikacionet mobile.

Ky projekt synon të garantojë vazhdimësinë operacionale, rritjen e performancës, rritjen e sigurisë dhe shkallëzueshmërinë e sistemeve, duke përgatitur terrenin për digjitalizim të mëtejshëm dhe integrim me platforma moderne të menaxhimit të të dhënave dhe shërbimeve ndaj qytetarëve.

1.1. Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është modernizimi i platformës ekzistuese të Sistemit Informatik Billing & CRM, nëpërmjet përmirësimit të teknologjisë që e mbështet dhe përditësimin të funksionaliteteve të tij kyçe, me synimin për të rritur efikasitetin, qëndrueshmërinë dhe përputhshmërinë me nevojat aktuale të operimit dhe zhvillimit të shërbimeve energjetike në kuadër të OSHEE Group sh.a.

Projektit i jepen prioritetet në vijim:

- Rritja e performancës së përgjithshme të sistemit në nivel hardware dhe software për të përballuar fluksin në rritje të të dhënave dhe transaksioneve ditore;
- Përmirësimi i funksionaliteteve të sistemit CRM dhe Billing, në mënyrë që të ofrojë një përvojë më të mirë për përdoruesit dhe konsumatorët;
- Zgjerimi i kapaciteteve të sistemit për integrim me sisteme të tjera, për të garantuar një arkitekturë IT të ndërveprueshme dhe fleksibël;
- Rritja e sigurisë kibernetike dhe përputhshmërisë me standardet më të fundit të menaxhimit të të dhënave, privatësisë dhe auditimit;
- Zvogëlimi i ndërprerjeve në shërbim dhe përmirësimi i cilësisë së operimeve, nëpërmjet automatizimit dhe optimizimit të proceseve ekzistuese.

Ky projekt nuk synon vetëm zgjidhjen e kufizimeve teknike aktuale, por edhe krijimin e një baze të fortë për zhvillime dhe zgjerime të ardhshme, duke mbështetur vizionin strategjik të OSHEE Group për një transformim digjital të qëndrueshëm dhe të integruar.

1.2. Objektivat

Për realizimin e qëllimit të projektit, janë përcaktuar objektivat specifike në vijim, të cilat përfaqësojnë rezultatet konkrete që do të arrihen gjatë implementimit të tij:

Upgrade i infrastrukturës hardware dhe software

- Përmirësimi i sistemit operativ dhe platformave software mbështetëse (p.sh., baza të dhënash, sisteme virtualizimi, backup etj.);
- Migrimi i sigurt i të dhënave dhe shërbimeve në infrastrukturën e re me ndërprerje minimale.

Përditësimi i funksionaliteteve të sistemit CRM dhe Billing

- Auditimi funksional i moduleve ekzistuese dhe identifikimi i pikave kritike për përmirësim;
- Zbatimi i ndryshimeve në logjikën e përpunimit të të dhënave për përputhje me rregulloret dhe nevojat e reja operacionale;
- Përmirësimi i ndërfaqeve të përdoruesit për akses më të lehtë, raportim më efikas dhe menaxhim më të mirë të kërkesave të klientëve;
- Shtimi i funksionaliteteve të reja për monitorim, analizë dhe menaxhim dinamik të klientëve dhe shërbimeve të tyre.

Sigurimi i kapaciteteve për integritet të reja

- Krijimi i një arkitekture të hapur dhe të standardizuar (API, Web Services) për integrim me sisteme të tjera si:
 - ERP (menaxhimi financiar dhe materialet)
 - WFM (menaxhimi i forcës punëtore në terren)
 - Portale digjitale për klientët
 - Sistemet e menaxhimit të matësve
 - GIS

**Të gjitha integrimet do të përshkruhen në mënyrë të detajuar në dokumentin e Analizës së Biznesit*

** CIS do të integrohet përmes API-ve të middleware dhe nuk do të ketë integrim të drejtpërdrejtë me shitësin.*

Rritja e sigurisë dhe përputhshmërisë me standardet

- Zbatimi i masave të përforcuara të sigurisë (autentifikim shumëfaktorësh, enkriptim të të dhënave në pushim dhe gjatë transmetimit, logim dhe auditim i plotë);
- Sigurimi i përputhshmërisë me standarde ndërkombëtare si ISO/IEC 27001, GDPR, dhe kërkesat e brendshme rregullatore;
- Krijimi i një infrastrukture të rikuperimit në rast fatkeqësie (DR) dhe politikave të backup të automatizuara.


Mbështetja e trajnimit dhe transferimit të njohurive

- Trajnimi i stafit teknik dhe përdoruesve fundorë mbi funksionalitetet e reja dhe procedurat operacionale;
- Dorëzimi i dokumentacionit të plotë Teknik dhe funksional;

2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I SISTEMIT

2.1 Përshkrimi i përgjithshëm i sistemit

Sistemi Billing&CRM i OSHEE Group Sh.a., është sistemi kryesor përmes të cilit katër kompanitë kryejnë proceset kryesore që lidhen me infrastrukturën dhe rrjetin energjistik, abonentët, faturimin periodik dhe arkëtimin e të ardhurave, printimin e faturave etj. Nga pikëpamja funksionale, ndërfaqja e sistemit është e organizuar në modulet e mëposhtme:



- Leximi i matësve
- Portali i Selfcare-t.
- Sistemi i Menaxhimit të Informacionit
- Ndërprerjet dhe Mbylljet.
- Shërbimi ndaj Klientit.
- Lidhje e re.
- Pagesat.
- Faturim.
- Konfigurime.
- Sistemi i Balancimit të Energjisë.

Përmes sistemit të Billing&CRM dhe integritit të tij me sisteme të tjera, OSHEE Group-it i mundësohet kryerja e proceseve thelbësore si, grumbullimi dhe administrimi i të dhënave të abonenteve dhe infrastrukturës së rrjetit energjistik, realizon kryerjen e proceseve të leximit/ faturimit/arkëtimit të abonentëve, gjenerimit dhe printimit të faturave të energjisë etj. Proçese si

çelja e kontratës së një abonent, hedhja dhe marrja e leximit mujor, përpunimi i leximit deri në gjenerimin e faturës, printimin e faturave, menaxhimin e matësive, krijimin e lidhjeve të reja dhe menaxhimin e të dhënave të abonentit, hedhja e pagesave, administrimi i debitorëve, krijimi i aktmarrëveshjeve, ndërprerjet, ankesë/kërkesat, workforca etj janë proçese thelbësore për mbarëvajtjen e punës në katër kompanitë. Gjithashtu, nëpërmjet modulit të Sistemit të Menaxhimit

të Informacionit, kompanitë marrin raportime analitike dhe sintetike mbi situatën e proçeseve. Sistemi është i integruar dhe shkëmben informacion me sisteme të tjera (p.sh sistemin e fiskalizimit, sistemin e kryerjes së leximeve, matjes online etj.).

Ky seksion përshkruan në mënyrë të detajuar fazat dhe aktivitetet kryesore që do të realizohen gjatë ciklit të jetës së projektit për upgradin e teknologjisë hardware/software, përditësimin e funksionaliteteve të Sistemit CRM dhe Billing, si dhe integrimet potenciale.

2.2 Analiza e situatës ekzistuese

- Inventarizimi i infrastrukturës aktuale teknologjike (hardware, software, rrjet, backup, etj.)
- Vlerësimi i performancës dhe kufizimeve të sistemit aktual CRM & Billing
- Identifikimi i risqeve, pengesave dhe kërkesave prioritare për përmirësim
- Hartimi i raportit të analizës së gjendjes aktuale (technical baseline)

2.3 Projektimi teknik dhe përzgjedhja e teknologjisë

- Hartimi i një arkitekture të përmirësuar sistimore dhe të rrjetit
- Përzgjedhja e platformave hardware dhe software të përputhshme me kërkesat aktuale dhe pritshmëritë afatgjata
- Identifikimi i moduleve që do të përditësohen, zëvendësohen ose zhvillohen nga e para
- Përcaktimi i kriterëve për integritime (standarde API, formate të dhënash, protokolle komunikimi)

2.4 Implementimi i infrastrukturës dhe aplikacioneve

- Zhvillimi dhe instalimi i platformave të reja
- Migrimi i të dhënave ekzistuese dhe konfigurimi i sistemeve
- Zbatimi i ndryshimeve në sistemet CRM dhe Billing sipas specifikimeve të miratuara
- Integrimi me sistemet e tjera në përdorim, nëse është e nevojshme

2.5 Testimi funksional dhe teknik

- Zhvillimi i planeve të testimit (test cases, skenarë, rezultate të pritshme)

- Testimi i moduleve të përditësuara dhe sistemit si një tërësi
- Testimi i integriteteve dhe performancës së përgjithshme
- Rregullimi i gabimeve të identifikuara gjatë testimeve

2.6 Trajnimi dhe dorëzimi

- Organizimi i trajnimeve për administratorët teknikë dhe përdoruesit fundorë
- Dorëzimi i manualeve të përdorimit dhe dokumentacionit Teknik
- Aktivizimi i versionit përfundimtar të sistemit në ambientin e prodhimit (Go-Live)

2.7 Mbështetja pas implementimit

Mbikëqyrja e sistemit për një periudhë prove pas aktivizimit.

Korrigjimi i çështjeve që mund të lindin gjatë përdorimit real

3. REZULTATET QË DUHET TË ARRIHEN

Zbatimi i këtij projekti do të çojë në dorëzimin e një sërë rezultatesh konkrete, të matshme dhe të dokumentuara, të cilat përfaqësojnë përmbushjen e objektivave të përcaktuara. Rezultatet e pritshme përfshijnë:

3.1. Infrastrukturë moderne dhe funksionale

- Sisteme operacionale dhe platforma software të konfiguruar sipas standardeve të sigurisë dhe performancës
- Kalimin e Software në Hardware të ri.

3.2 Sisteme CRM dhe Billing të përditësuara

- Module të përmirësuara me funksionalitete të reja dhe ndërfaqe të optimizuara për përdoruesit fundorë
- Zgjidhje të implementuara për trajtimin më efikas të kërkesave të klientëve, faturimit dhe menaxhimit të të dhënave

3.2. Integritet funksionale me sisteme të tjera

- API dhe mekanizma komunikimi për integrim me ERP, WFM, portale digjitale dhe sisteme të tjera ekzistuese
- Raportim në kohë reale dhe shkëmbim i automatizuar i të dhënave ndërmjet sistemeve

3.3. Dokumentacion teknik dhe përdorues

- Dokumentacioni teknik për konfigurimin e sistemit, arkitekturën, integrimet dhe masat e sigurisë
- Manuale përdorimi për administratorët dhe përdoruesit fundorë

3.4. Raporte të testimeve dhe verifikimeve

- Raporte të testimeve teknike, testimeve funksionale dhe të integritetit
- Vërtetimi i funksionalitetit dhe përputhshmërisë së sistemit me kërkesat e përcaktuara

3.5. Trajnime dhe transferim njohurish

- Sesione trajnimi të realizuara për grupet kryesore të përdoruesve
- Materiale trajnimi dhe certifikim i pjesëmarrësve (nëse aplikohet)

3.6. Raport përfundimtar i projektit

- Raport që përmbledh gjithë procesin e implementimit, rezultatet e arritura, rekomandime për mirëmbajtjen dhe zhvillimet e mëtejshme

4. SUPOZIMET DHE RISQET

a. Supozimet

Faktori kyç i finalizimit me sukses të upgrade të teknologjise hardware/software, perditësim të funksionaliteve të Sistemit CRM dhe Billing si dhe integrimet potenciale është analizimi i kujdesshëm i proceseve ekzistuese të punës dhe i të gjithë sistemit aktual në tërësi. Bashkëpunimi me stafin e departamentit të IT-së së OSHEE do të lehtësojë mbledhjen e informacioneve të duhura rreth sistemit ekzistues.

b. Risqet

- Mosanalizimi i mirë i situatës aktuale të punës.
- Keqinterpretimi i faktorëve që ndikojnë në performancën e sistemit.
- Vonesa në procesin e analizës dhe reagimit në rast mosfunksionimi të sistemit.
- Mosmarrja në konsideratë e volumit të punës bazuar në numrin e përdoruesve në sistem.

5. DETYRAT SPECIFIKE

5.1 Fazat e Implementimit të Projektit

Zbatimi i këtij projekti do të realizohet në disa faza të ndara, të cilat do të ndiqen në mënyrë të strukturuar dhe të kontrolluar. Kohëzgjatja totale e projektit parashikohet të jetë 12 muaj (sipas përcaktimeve të mëtejshme teknike dhe organizative), me ndarje të afateve si më poshtë:

Faza 1: Analiza dhe Projektimi Teknik

- Vlerësimi i gjendjes aktuale
- Hartimi i specifikimeve teknike
- Përgatitja e planit të implementimit dhe analizës së riskut

Faza 2: Përgatitja e Infrastrukturës

- Instalimi dhe konfigurimi bazik i infrastrukturës teknologjike

Faza 3: Zhvillimi dhe Përditësimi i Sistemeve CRM/Billing

- Zbatimi i përmirësimeve në sistemin CRM dhe Billing
- Konfigurimi dhe integrimi me sistemet e tjera
- Migrimi i të dhënave historike

Faza 4: Testimi Teknik dhe Funksional

- Testimi i moduleve dhe integriteteve
- Verifikimi i sigurisë, performancës dhe përputhshmërisë me kërkesat
-

Faza 5: Trajnimi dhe Aktivizimi në Ambientin e Prodhimit (Go-Live)

- Trajnimi i stafit teknik dhe përdoruesve fundorë
- Aktivizimi i sistemit në Production dhe nisja e përdorimit aktiv

Faza 6: Mbështetja pas Implementimit dhe Mbyllja e Projektit

- Mbikëqyrja e performancës së sistemit
- Zgjidhja e çdo problematike pas implementimi
- Hartimi dhe dorëzimi i raportit përfundimtar

5.2 Dorëzimet

Ofruesi i shërbimit është i detyruar të dorëzojë të gjitha produktet e projektit në përputhje me afatet dhe standardet teknike të përcaktuara. Dorëzimet do të përfshijnë elementë teknikë, funksionalë, dokumentues dhe organizativë si më poshtë:

1. Dokumentacioni i analizës dhe projektimi

- Raport i gjendjes aktuale të sistemit CRM/Billing dhe infrastrukturës teknologjike
- Raport i analizës së kërkesave teknike dhe funksionale
- Arkitektura e re e propozuar për sistemin dhe rrjetin
- Plan i detajuar i zbatimit (roadmap teknik)

2. Infrastrukturë e instaluar dhe funksionale

- Pajisjet fizike të instaluar dhe të testuara
- Sisteme operacionale dhe platforma software të konfiguruar
- Sigurimi i aksesit të kontrolluar dhe dokumentuar për administratorët

3. Sisteme CRM dhe Billing të përmirësuar

- Funksionalitete të përditësuara dhe module të reja të zhvilluara
- Integritete të implementuara me sistemet e tjera
- Teste funksionale dhe teknike të përfunduara me sukses

4. Manuale dhe dokumentacion Teknik

- Manual përdorimi për përdoruesit fundorë dhe administratorët
- Dokumentim teknik për konfigurimet, parametrat, integritet dhe politikat e sigurisë
- Dokumentim i planeve të backup dhe rikuperimit në rast fatkeqësie (DR Plan)

5. Trajnime për përdoruesit dhe stafin Teknik

- Realizimi i sesioneve trajnuese sipas profileve të përdoruesve
- Lista e pjesëmarrësve dhe materialet përkatëse
- Vlerësim i njohurive për përdorim të sistemit pas trajnimit

6. Raporte për testim dhe kontroll cilësie

- Plan testimi (test plan), skenarë testimi dhe raportet përkatëse (test reports)
- Raporte të validimit për përputhjen me kërkesat
- Dokumentim i çdo problemi të identifikuar dhe mënyra e zgjidhjes

7. Raport përfundimtar i projektit

- Përmbledhje e të gjitha fazave të zbatimit
- Përshkrimi i produkteve të dorëzuara
- Rekomandime për mirëmbajtje dhe përmirësime të vazhdueshme

5.3 Mbikëqyrja dhe Raportimi

Për të siguruar realizimin e suksesshëm të projektit dhe për të monitoruar progresin në mënyrë efektive, do të zbatohen mekanizma të qartë mbikëqyrjeje dhe raportimi. Këto do të garantojnë transparencë, cilësi, si dhe përputhje me objektivat dhe afatet e përcaktuara në këtë dokument.

Struktura e mbikëqyrjes së projektit

- Projekti do të mbikëqyret nga një Grup Përcjellës Teknik dhe Menaxherial, i përbërë nga përfaqësues të:
 - Departamentit të Teknologjisë së Informacionit
 - Njësive funksionale të përfshira në përdorimin e sistemit CRM/Billing
 - Menaxhimit të projektit dhe cilësisë
- Ky grup do të ketë rolin e:
 - Miratimit të planeve dhe dokumentacionit teknik
 - Përcjelljes së progresit dhe zgjidhjes së pengesave
 - Verifikimit të dorëzimeve dhe kontrollit të cilësisë

Raportime periodike

- Ofruesi i shërbimit do të dorëzojë raporte dyjavore të progresit, të cilat do të përfshijnë:
 - Aktivitetet e realizuara
 - Probleme të hasura dhe masa të marra
 - Parashikime për aktivitetet e ardhshme
 - Vonesat ose devijimet nga plani i miratuar (nëse ka)
- Raportet do të dorëzohen në format të strukturuar dhe do të diskutohen në takime të rregullta me Grupin Mbikëqyrës.
- Projekti do të ndahet në fazat kryesore, secila prej të cilave do të përmbyllet me:
 - Dorëzime specifike (deliverables)
 - Testime dhe verifikime
 - Takime zyrtare të miratimit (sign-off)
- Kalimi në fazën pasuese do të bëhet vetëm pas miratimit të plotë të piketës përkatëse.

Mekanizmat e kontrollit të cilësisë

- Për çdo komponent të dorëzuar, do të aplikohen:
 - Kritere të qarta teknike dhe funksionale
 - Testime teknike, funksionale dhe të integritetit
 - Vlerësim nga grupi i verifikimit dhe përdoruesit fundorë

Çdo mospërputhje do të trajtohet në mënyrë të dokumentuar dhe do të kërkohet rregullim nga ofruesi i shërbimit.

- Komunikimi dhe transparenca
- Të gjitha palët do të kenë akses në një mjedis të përbashkët raportimi (p.sh. platformë projektimi ose sistem menaxhimi projekti)
- Komunikimi do të jetë i vazhdueshëm dhe do të përfshijë takime javore fizike.

5.4 Mbledhja, specifikimi dhe dokumentimi i analizës së kërkesave

Në kuadër të projektit për “Upgrade të Platformës CRM/Billing”, një nga komponentët themelorë është realizimi i një analize të plotë të biznesit dhe teknologjisë, e cila do të shërbejë si bazë për të gjitha fazat e mëtejshme të zbatimit. Kjo analizë do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me palët e interesuara nga OSHEE Group Sh.a. dhe do të formalizohet përmes dokumenteve standarde të menaxhimit të projekteve dhe inxhinierisë së kërkesave.

5.4.1 Qëllimi i analizës

- Të identifikojë dhe përshkruajë të gjitha nevojat dhe objektivat operacionale të kompanive të OSHEE Group që lidhen me sistemet CRM/Billing;
- Të dokumentojë në mënyrë të strukturuar kërkesat funksionale dhe jo-funksionale, në përputhje me dokumentacionin teknik të tenderit dhe specifikimet ekzistuese;
- Të ndërtojë një bazë të qartë referimi për zbatimin teknik, testimin dhe validimin e sistemit të përmirësuar.

5.4.2 Përmbajtja e analizës së biznesit

Analiza e biznesit dhe dokumentimi i kërkesave do të përfshijnë:

- Shqyrtim i detajuar i projektit
Analizë e qëllimit, përfitimeve të pritshme dhe ndikimit në proceset ekzistuese;
- Identifikimi i nevojave të biznesit
Intervistim dhe koordinim me palët e interesuara (stakeholders) për të nxjerrë kërkesat reale funksionale dhe sfidat aktuale;
- Dokumenti i kërkesave funksionale (FRD – Functional Requirements Document)
Përshkrimi i plotë i funksionaliteteve të nevojshme në sistemin CRM dhe Billing (input, përpunim, output, rregulla biznesi, etj.);
- Dokumenti i kërkesave teknike dhe jo-funksionale
Kërkesat për performancë, siguri, disponueshmëri, auditim, integritet, etj.;
- Plani kohor i zbatimit të projektit (Gantt chart/roadmap)
Aktivitete, ndërvarësi, afate të përcaktuara dhe përgjegjësi për çdo fazë;
- Plani i menaxhimit të cilësisë
Mënyra e matjes dhe verifikimit të cilësisë së dorëzimeve gjatë projektit;

- Identifikimi i palëve të interesuara dhe përgjegjësitë e tyre
- Matrica RACI (Responsible, Accountable, Consulted, Informed);
- Plani i komunikimit
Kanale, formate, frekuencë dhe përgjegjësi për raportimet gjatë gjithë ciklit të projektit;
 - Plani i menaxhimit të rrezikut
Identifikimi i risqeve të mundshme, analizë ndikimi, probabiliteti dhe masat parandaluese ose korrigjuese.

5.4.3 Afati i realizimit të analizës

- Ofruesi i shërbimit është i detyruar të përgatisë analizën e biznesit dhe dokumentacionin përkatës brenda një periudhe të përcaktuar nga OSHEE Group sh.a, zakonisht jo më vonë se 8 javë nga data e fillimit të projektit.
- Dorëzimi do të përfshijë:
 - Dokumentin përfundimtar të analizës së kërkesave
 - Planin e zbatimit të projektit
 - Prezantim zyrtar për palët e interesuara me qëllim miratimin e analizës

6. KËRKESAT FUNKSIONALE

6.1 Upgrade i Platformes Billing/CRM

- Upgrade i report servers ne versionet me te fundit;
- Upgrade I aplikacionit dhe database ne versionet me te fundit;
- Upgrade i server të aplikacionit ne versionet me te fundit;
- Upgrade i server të databazës ne versionet me te fundit;
- Upgrade i sistemit të operimit për server të aplikacionit dhe server te databases;
- Përshpejtimi i proceseve të punës të sinkronizimit me skemën ndërmjetëse CRM-MR;

6.2 Ndryshime dhe përmirësime në platformen Billing/CRM

Kërkesat funksionale përbëjnë përshkrimin e funksioneve që sistemi duhet të kryejë për të mbështetur proceset e biznesit të OSHEE Group. Ato bazohen në praktikat ekzistuese dhe në objektivat e përmirësimit që synon ky projekt. Më poshtë pasqyrohen kërkesat funksionale të përgjithshme të cilat do të aplikohen tek secili prej kodeve të shërbimeve:

Kërkesat për Sistemin CRM (Customer Relationship Management)

Sistemi CRM (Customer Relationship Management) do të mundësojë menaxhimin e plotë të të dhënave të klientëve, ndjekjen e ciklit të plotë të marrëdhënies me ta nga regjistrimi, shitjet, kontratat, faturimi dhe shërbimi ndaj klientit duke ofruar një pasqyrë të centralizuar dhe të azhurnuar

në kohë reale. Sistemi CRM duhet të mbështesë automatizimin e proceseve të shitjes, komunikimin e personalizuar, analizat e performancës dhe integrimin me sisteme të tjera si ERP, Billing dhe suport teknik.

6.2.1 Moduli Customer Support

Moduli **Customer Support** në sistemin CRM do të mundësojë regjistrimin, menaxhimin dhe ndjekjen e kërkesave, ankesave apo incidenteve të klientëve në mënyrë të strukturuar dhe të gjurmueshme. Ai do të sigurojë komunikim efikas me klientin, kategorizim të çështjeve sipas prioritetit, statusit dhe tipologjisë, si dhe do të ofrojë historik të plotë për çdo rast. Gjithashtu, do të mbështesë integrimin me kanale të ndryshme kontakti (email, telefon, portal) dhe mundeson raportim për performancën e shërbimit ndaj klientit.

Nr. Kërkesa Funksionale CRM

- 1 Regjistrimi dhe menaxhimi i të dhënave të klientëve (abonentë familjarë dhe biznese)
- 2 Krijimi, ndryshimi dhe menaxhimi i kontratave të furnizimit me energji elektrike
- 3 Historiku i ndërveprimeve me klientin dhe kërkesave të paraqitura
- 4 Moduli për trajtimin e ankesave dhe ndjekjen e statusit të tyre në kohë reale
- 5 Menaxhimi i takimeve dhe komunikimeve me klientët (telefon, email, aplikacion, portal)
- 6 Segmentimi i klientëve bazuar në profile
- 7 Regjistrimi dhe gjurmimi i kërkesave për lidhje të re, ndërprerje ose rikthim furnizimi
- 8 Gjenerimi i raporteve për performancën e shërbimit ndaj klientit dhe SLA-të
- 9 Akses i personalizuar sipas roleve (agjent, menaxher, admin)

Lidhur me ndryshimet e kodeve me kategoritë, nënkategoritë dhe workflow të secilit proces, si më poshtë:

KODI/ KATE GORIA	KODI/NËNKATEGORIA	REKOMANDIMI
F / Ankesë për Faturim (Billing Complai n)	F1 \Kryqëzim Matësi F2 /Tarifim i gabuar F3 /Ankesë për TV TAX F4 /Ekzekutim Vendim Gjykate F5 /Kërkesë për rimbursim / disbursim F6 /Faturim pas pezullimi / Terminimi	1. Për të gjitha kodet F, në workflow: • <u>Hapi 1</u>: Specialisti i KNK-së/Supervizori - t'i shfaqet seriali i faturave, ku të bëjë përzgjedhjen e faturës përkatëse. • <u>Hapi 2</u>: Supervizori KNK-së. • <u>Hapi 3</u>: Specialisti i DMK-së - t'i shfaqet dhe të përzgjedhë faturat që konceptohen/ankimohen. • <u>Hapi 8</u>: Specialist Faturimi - nuk duhet t'i shfaqet faturë tjetër përtej atyre të ankimuara. 2. Në rastet e ankesës për faturim, kur çështja është përfunduar: • Përgjigjja negative i shkon me postë. Po kjo përgjigje duhet t'i shkojë automatikisht nga sistemi, me SMS dhe e-mail. • Përgjigjja pozitive, t'i shkojë automatikisht me sms dhe e-mail. • Format i dhe përmbajtja e përgjigjes përfundimtare ekziston, por duhet rishikuar. 3. Kodet F1 dhe F2 të transformohen në "FUSHA" për t'u përzgjedhur në aplikim. 4. Të shtohet funksionaliteti i rihedhjes së dokumentit (upload) nga ana e aplikuesit, në rastet kur mungon dokumenti i nevojshëm, apo në rastet kur kërkohet dokument shtesë. 5. Në procesin e verifikimit të gjobave të dëmeve të shkaktuara në vitin 2011/2012, aktualisht në kodin F5, është propozuar që të konsiderohet heqja e Operatori i Sistemit të Shpërndarjes Sh.A. (OSSH) në workflow për kryerjen e verifikimit. Ky propozim mund të konsiderohet vetëm në rast se: • krijohet një Kod i ri, specifikisht për dëmet e kësaj periudhe (sepse OSSH-ja, nuk mund të bëjë më verifikime në matës, pas një periudhe kaq të gjatë kohore) dhe ku të dorëzohet pranë Departamentit të IT-së, lista e numrave serial të faturave të dëmeve të periudhës 2011/2012 që Dep. i IT-së duhet ta kërkojë zyrtarisht nga FSHU-ja dhe OSSH-ja (kjo tregon

		se në momentin që kjo listë integrohet në sistem, nuk do të lejohet të shfaqet numër serial matësi, apo numër kontrate tjetër jashtë listës). 6. Propozohet të Hiqet Kodi F3 dhe funksionet e tij bashkohen në kodin K12 (K12/Përfundim nga TV Tax.) që do trajtohen nga DMRK. 7. Aktualisht nga sistemi informatik nuk dërgohet njoftim mbi statusin e aplikantit. Rekomandohet që njoftimi i abonentit sipas çdo hapi të workflow, që në fazën e aplikimit (dhe në fazën e ndërmjetme nëse është e nevojshme), e deri në fazën e mbylljes së aplikimit të kryhet me SMS dhe e-mail automatike, sipas një formati të përcaktuar e të strukturuar: Pranuar: qytetari merr njoftimin online mbi statusin “Pranuar” dhe i jepet një kod unik për të gjurmuar çështjen. Në proces: Pasi dokumentacioni konsiderohet i rregullt/pranuar, specialisti kalon praktikën për verifikim në terren dhe më pas dërgohet për konceptim, verifikim, miratim, autorizim dhe ekzekutim sipas workflow përkatës. Mbyllur: Abonenti merr komentimin online që çështja e tij është mbyllur. Refuzohet: Kur aplikimi nuk përmbush asnjë kriter të nevojshëm për shërbimin e kërkuar aplikimi “Refuzohet”, qytetari merr njoftimin e nevojshëm për mos-pranimin e aplikimit. 8. Të shtohen fushat e të jenë të detyrueshme: • Numër telefoni, Adresa, ID-ja, NIPT-i, e-mail. • Të shtohet numri i karaktereve tek kutia ”shënime”. • Të mundësohet depozitimi i të dhënave për shtetasit e huaj (ID, Pasaportë). 9. Pas regjistrimit të ankesës, formulari përfundimtar duhet të përditësojë të gjithë të dhënat e depozituara nga specialist i KNK-së në momentin e aplikimit, pasi janë shtuar fushat e detyrueshme. 10. Të shtohet një kuti/fushë e titulluar ”Përshkrimi” dhe shtimi i karaktereve për të mundësuar për lënien e komentit nga titullari i hapit.,
--	--	---

		tek: • “Site Inspection Details Verification”. Po ashtu, të mundësohet kontrolli (check-u) i faturave të propozuara për zbritje. • “Site Inspection Details Approval”. • “Authorization”. • “Authorization Approval”. • Billing Complaints”. 11. Përgjigjja përfundimtare, e cila do të jepet automatikisht nga sistemi duhet t'i referohet faturave të zbrituara dhe atyre të kontrolluara (check-uara) nga specialisti i KNK-së. 12. Kodi F4 make inactive
B / Ankesa për pagesa / kreditim e (Payments Complaints)	B1/Kreditim Pagese (Posta) B2/Kreditim Pagese (Bank) B3/Kreditim Pagese (Arka OSHEE) B4/Kreditim Pagese (MM) B5/Ekzekutim Vendim Gjykate B6/Kërkesë për Kthim Shume (pagesë e gabuar)	1. Të gjashtë kodet do të grupohen në vetëm dy: • B1: Kreditim Pagese për të gjitha kanalet (all B1-B4) . • B2: (njelloj si B6) Kthim shume në llogarinë bankare të klientit me 2 fusha: a. . Kthim shume kompensim për mbifaturim; • B. . Kalim vlerë nga një kontratë në tjetrën; 2. Sipas pikës 1, kodet B/1, B/2, B/3 dhe B/4 do të shndërrohen në “FUSHA” për t'u përzgjedhur pasi është filluar aplikimi me kodin B1 (ku do të përfshihen këto fusha). Refuzohet:
C / Cilësi Shërbimi	C1/Defekt i Kabinës; C2/Defekt i Rrjetit; C3/Defekt në Shtyllë; C4/Vjedhje e Aseteve të Kompanisë;	1. Tre kodet e para (C1, C2, C3) që kanë lidhje me ankesat e konsumatorëve për defekte, të grupohen në një kod të vetëm “Kodi C”. 2. Kodi C do të titullohet “Ankesë për Defekte” dhe do të konsiderohet si shërbimi kryesor, që mund të përzgjidhet nga klienti Online, apo specialisti i KNK-së në kodet C. 3. Propozohet që të hiqen kodet: • C6 , C8, C9

	C5/Ankesë për Vjedhje të Energjisë; C6/Ankesë për Cilësinë e Energjisë; C7/Ankesë për ndërprerje të paplanifikuara të energjisë; C8/Ankesë për Vonesa në Shërbime; C9/Ankesë për Sjelljen e Punonjësve; C10/Ankesa të Tjera; C11/Kërkesë për Dëmshpërblim që Rrjedhin nga Cilësia e Furnizimit me Energji; C12/Kërkesë për Dëmshpërblim që rrjedhin nga Dëmet e Luhatjes së Tensionit; C13/Kërkesë për Dëmshpërblim që Rrjedhin nga Vonesat në Kthim Përgjigje të Shërbimeve.	• Njoftim i klientit me SMS/email - Aplikimi u pranua - Krkesa u perfundua 4. Propozohet që të ndryshohen/shkurtohen këto hapa në workflow: • Hapi 1 - “Complaint Registration” të shkrihet me hapat “Complaint/Request Document Upload” dhe “Dispatch”. Në këtë rast specialisti i KNK-së të ketë akses për të marrë/kryer aplikimin, të upload-ojë dokumentacionin dhe të klikojë “submit” për të vijuar më tej.. • Hapi 2 – “Complaint Verification” do të kryhet nga Kryeinxhinieri/Personi i autorizuar prej tij i Rajonit. (Sistemi duhet të delegojë çështjen tek ky rol sipas Town të kodit të kontratës që është përzgjedhur në Hapin e parë. Çdo Town do të ketë një Kryeinxhinier pritës për këtë Kod). Në këtë hap duhet të verifikohet ankesa dhe të ngarkohet Proces-Verbali me shpjegimin teknik të defektit dhe zgjidhjes së tij. • Hapi 3 – “Complaints closed”. Pas ngarkimit të Proces-Verbalit teknik në Hapin e dytë, çështja kalon në hapin e tretë për t’u mbyllur. Në ato raste kur çështjet do të zgjasin më shumë se 48 orë, atëherë Proces-Verbali duhet të përmbajë edhe arsyen e vonesës.
K / Ndryshi m i të Dhënave të Kontratës	K1/Saktësim i të Dhënave të Kontratës; K2/Ndryshime Emra Familjar; K3/Ndryshime Emra Jo Familjar; K4/Ndryshim i Përdoruesit të Pronës; K5/Heqje e Përdoruesit të Pronës;	1. Kodet K2 dhe K3 të shkrihen në një Kod të vetëm. 2. Kodi K1 do të qëndrojë siç është (AS-IS) dhe afati i brendshëm për përfundimin e çështjes të bëhet 10 ditë (nga 30 ditë sipas afatit ligjor). 3. Për Kodin K11 “Ndryshim Tarifimi në Zbritje”, propozohet që të bëhet kjo ndarje: 4. K11.1 sipas nivelit të tensionit, e cila do të jetë përgjegjësi e OSSH Sh.a, 5. K11.2 sipas klasifikimit biznes/familjarë, e cila do të jetë përgjegjësi e FSHU Sh.a. 6. Në lidhje me Kodin K6

K6/Riaktivizime të Kontratave; K7/Pezullime të Kontratës; K8/Mbyllje të Kontratës; K9/Rilidhje Shërbimi pas pezullimit të procesit të përmbartimit K10/ K11/Ndryshim Tarifimi në Zbritje; K12/Përfshirje nga TV Tax.	“Riaktivizime të Kontratave”, propozohet që statusi i rilidhjes të behët automatikisht nga sistemi i IT-së. Te shtohet një hap pas konfirmimit të supervisorit, akses duhet të ketë specialisti i menaxhimit të kontratave, specialisti i matjes duhet të përcaktoj në sistem nëse janë ndryshuar vlerat apo matësi, do të kalojë në menaxhim të matjes në qendër dhe do të ndryshohet statusi i kontratës mbyllet workflow Duhet të shtohet hapi për WFM që të refuzohet ose tja kthejë menjëherë për rastet kur është i pamundur riaktivizimi në terren. Pasi specialisti i matjes konstaton ndryshim vlerash dhe/ose matësi cështja duhet të delegohet tek sektori i matjes në qendër, përkatesisht në modulet e ndryshimit të vlerave ose të matësit në varësi të situatës, jo nëpërmjet cështjes së riaktivizimit 7. Në lidhje me Kodin K7, K8 “Pezullime të Kontratës” propozohet që, përpara se OSSH Sh.a. të bëjë pezullim matësi, të marrë aprovim fillimisht nga FSHU Sh.a. Kjo do të thotë një hap të ri në workflow. *SHTESE INFORMACION NGA OSSH-FSHU) Po ashtu, propozohet që përpara mbylljes së çështjes, të shtohen hapa të tjera për zbritje të debisë deri në zero. 8. Në lidhje me Kodin K9 “Rilidhje Shërbimi pas pezullimit të procesit të përmbartimit” propozohet që, të krijohet një modalitet i ri për përmbartimin (midis FSHU Sh.a. dhe Departamentit Ligjor të OSHEE Group). Po ashtu, propozohet që të kalohen abonentët nga statusi “Bill Stop” në “Përmbartim”. Aktualisht ky proces është Offline, prandaj propozohet që të kalojë plotësisht Online. 9. Në kodin K12, do të shfaqen për për zgjedhje opsionet e mëposhtme : - Hiqje e tv tax - Zbritje e tv tax - Kthim pagese tv tax
--	---

